



PËR: Mjekët anëtarë të Odës së Mjekëve të Kosovës;

NGA: Këshilli Drejtues i Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK);

LËNDA: Njoftim lidhur me procesin e rekrutimit për shkollim specialistik

Datë: 04 gusht 2020

Të nderuar anëtarë,

Sic edhe jeni të njoftuar dhe që tanimë të gjithë nga ju që jeni të interesuar që të aplikoni në konkursin e hapur për shkollim specialistik, OMK-ja ka paraqitur kundërshtimet e saj lidhur me procesin e shkollimit specialistik. Kundërshtimet e OMK-së kanë përfshirë si bazën juridike, ashtu edhe procesin mbi të cilin është ndërtuar infrastruktura organizative e procesit të shkollimit specialistik. Brengë më e madhe e OMK-së është tjetërsimi i komptencave ligjore që jo vetëm OMK-së, por edhe odave të tjera të profesionistëve shëndetësor u është mohuar me këtë proces.

Sido qoftë, pavarësisht kundërshtimeve që mund t'i kemi me këtë proces të rëndësishëm profesional, të gjithë mjekët anëtarë të OMK-së janë të mirë se ardhur që t'i shfrytëzojnë shërbimet e Odës në raport me të gjitha nevojat personale të të gjithë mjekëve që aplikojnë për t'iu nënshtuar shkollimit specialistik.

Për çdo informatë dhe çdo udhëzim që ju nevojitet, Ju lutemi që ta kontaktoni Shërbimin Profesional të OMK-së, në mënyrë që të gjithëve t'i lehtësohet aplikimi në këtë proces.

Ju lutemi që në çdo kohë kur vizitoni hapësirat e administratës së OMK-së, t'i respektoni masat mbrojtëse nga COVID-19 dhe t'i përbaheni rekomandimeve të IKShPK-së, për sa i përket preventivës ndaj infektimit nga COVID-19.

Kjo komunikatë lëshohet me qëllim të demantimit të propagimit të bërë në komunitetin mjekësor përmes mediumeve të caktuara se kinse OMK-ja është duke u angazhuar për të sabotuar procesin e rekrutimit të spesializantëve. OMK-ja është angazhur në 3 vitet e fundit që procesi të zhvillohet brenda standardeve ligjore që janë të parapara me legjislacionin në fuqi. Dhe pikërisht OMK-ja është e vetmja organizatë e cila ka ngritur shqetësimin e papunësisë të mjekëve specialist dhe ka dhënë sugjerime mbi alternativa për zgjidhjen e problemit të tillë, duke propozuar që procesi i shkollimit specialistik të organizohet në përputhje me kërkuesat aggregate të institucioneve shëndetësore dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Me respekt,

Prishtinë, 04 gusht 2020

Këshilli Drejtues i OMK-së



Faqe 1 nga 1